

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.Ll. nga Gj., për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1130/2017 të datës 03.11.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **12.02.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarve të dëmtuarve H. B. dhe A. H., mbrojtësit të akuzuarit Av. M. S. dhe të akuzuarit I. L., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. L. nga Gj. „Rr” T. Q. “ nr. ....**, i biri i B. dhe i nënës Z. e gjinisë B., i lindur me dt. ... ne Gj., ka te kryer shkollën e mesëm, pensionist, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar at i 3 fëmijëve, me nr. ID .....

### Ë s h t ë f a j t o r:

#### Sepse :

-me dt.23.07.2017, rreth orës 20.40 min, në Gj., në rrugën “N.T. “duke drejtuar automjetin e markës “..” tipi ... me targa .regj...., me ngjyrë hiri metalike, nuk mban shiritin e tij drejtimi i lëvizjes e nuk përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve e rrethanave në rrugë e vepron në kundërshtim me nenin 48par.4/1 lidhur me nenin 51par.4/1 të Ligjit Nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugorë, e rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve e pasurin, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mosveprimi i tij me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet ose do e parandaloj dhe pasoja është shkakuar, në atë mënyrë që në gjendje të dehur sipas raportit policorë duke drejtuar automjetin në drejtim të semaforëve, me të kaluar të Gjykatës nga shiriti i tij kalon majtas në shirin për qarkullim të automjeteve në kahje të kundërt, e me pjesën e përparme të krahut të majtë në pjesën anësore të krahut të majtë e godet automjetin e markës “O. C.” me tar. regj ....., ngjyrë e zezë, pronë e L. M. nga P. „Rr.” H. e D. “nr. ..., e nuk ndalet, e vazhdon duke drejtuar automjetin në drejtim të semaforëve ku me pjesën ballore nga pas e godet automjetin e markës “F.”, tipi “F.”, me tar. regj. ...., ngjyre hiri metalike, pronë e A. H. nga Gj. „rruga “L D.”, e dëmton automjetin e tij ndërsa të dëmtuarit I. F. nga P. „rruga “Sh. B.” nr... , i shkakton dëme material ne automjet dhe lëndime te lehta trupore, ndërsa pasagjerit te tij A. F. i nga P. i shkakton lëndime te lehta trupore, e po ashtu te dëmtuarit H. R. B. nga Gj. „rruga “D. Gj. L.” nr. ..., i shkakton dem material ne automjet si dhe pasagjerit te tij ne automjet te dëmtuarit A. H. nga Gj. „rruga “L. D.” i shkakton lëndime te lehta trupore te përshkruara ne ekspertizën mjeko –ligjore te Dr. V. H., dt. 05.10.2017.

**-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së.**

**Gjykata në mbështetje të nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 378/6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:**

### DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **180(njëqind e tetëdhjetë ) ditësh** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në shumë prej **90.88 euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumen prej **20 euro** ,e këtë në afatin prej **15 ditësh** pasi që aktgjykimi të merr formë të prere nën kërçenim të përbarimit me dhunë .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1130/2017 të datës 03.11.2017,e ka akuzuar të akuzuarin I.Ll. nga Gj. për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6-1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të 12.02.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj , lexon aktakuzën PP.nr.1130/2017 të datës 03.11.2017, me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet në tersi pranë aktakuzës.

I akuzuari I. Ll. , gjatë shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. M. S. ,thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsërite dhe do të jem me i kujdesshëm, kërkojë falje nga të dëmtuarit për demin dhe lëndimet e shkaktuara andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur në gjykatë për veprën e kryer , premtimi se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm dhe nuk do ta përsërisë ndonjë veprë penale apo të ngjashme , si dhe faktin se është hera e parë që kam ra në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

I dëmtuari H. B. ,gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari ,nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penalë ndërsa kompensimin e demit do ta realizojë nga kompania e sigurimeve

I dëmtuari A. H. , shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari ,nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penalë ndërsa kompensimin e demit do ta realizojë nga kompania e sigurimeve

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit prokurori i shtetit Ismet Tofaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndes, i propozoi gjykatës që të merr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike si dhe mos denueshmerinë e me parshme .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari I Ll : me dt.23.07.2017, rreth orës 20.40 min, në Gj., në rrugën “ N.T. “duke drejtuar automjetin e markës “... ”tipi .. me targa .regj.... ,me ngjyrë hiri metalike, nuk mban shiritin e tij drejtimi i lëvizjes e nuk përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve e rrethanave në rrugë e vepron në kundërshtim me nenin 48par.4/1 lidhur me nenin 51par.4/1 të Ligjit Nr.05/L-088 për rregullat

e trafikut rrugorë, e rrezikon trafikun publik , jetën e njerëzve e pasurin ,nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mosveprimi i tij me mendje lehtësi mendon se nuk do të shkaktohet ose do e parandaloj dhe pasoja është shkakuar , në atë mënyrë që në gjendje të dehur sipas raportit policorë duke drejtuar automjetin në drejtim të semaforëve , me të kaluar të Gjykatës nga shiriti i tij kalon majtas në shirin për qarkullim të automjeteve në kahje të kundërt , e me pjesën e përparme të krahut të majtë në pjesën anësore të krahut të majtë e godet automjetin e markës “O. C. ” me tar. regj ....., ngjyrë e zezë , pronë e L.M. nga P. ,Rr.” H.. e D. “nr....., e nuk ndalet ,e vazhdon duke drejtuar automjetin ne drejtim te semaforëve ku me pjesën ballore nga pas e godet automjetin e markës “..”, tipi “F.. “, me tar. regj. ...., ngjyre hiri metalike ,pronë e A. H. nga Gj. ,rruga “L D. ” ,e dëmton automjetin e tij ndërsa te dëmtuarit I. F. nga P ,rruga “Sh. B ” nr. .. ,i shkakton dëme material ne automjet dhe lëndime te lehta trupore, ndërsa pasagjerit te tij A. F. nga P. i shkakton lëndime te lehta trupore ,e po ashtu te dëmtuarit H.R. B. nga Gj. ,rruga “D.Gj. L. ” nr...., i shkakton dem material ne automjet si dhe pasagjerit te tij ne automjet te dëmtuarit A.H. nga Gj ,rruga “L. D. ” i shkakton lëndime te lehta trupore te përshkruara ne ekspertizën mjeko –ligjore te Dr. V.H. ,dt. 05.10.2017.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimit është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 3 fëmijëve , pranimitin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, gjendjen e varfër ekonomike, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , premtimi se ne te ardhmen nuk do te jetë me i kujdesshëm ,kërkim falja nga te dëmtuarit për demin dhe lëndimet e shaktuara , deklarimi i të dëmtuarve se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale si dhe fakti se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim 180 (njëqind e tetëdhjetë ) ditësh, i cili dënim nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve te dëmtuara ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mur konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.753/17 më datë 12.02.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej 15 ditësh ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.